



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-30547/23 datë:17.11.2023



Npi – 01/434 datë: 27.11.2023

Bazuar në nenin 51 paragrafi 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 13 dhe 14 të Udhëzimi Administrativ të (MPL) Nr.05/2020 Për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

PËR PLOTËSIMIN E KOMITETIT PËR AMBIENT, SHËRBIME PUBLIKE DHE URBANIZËM ME ARTAN LUBOVCI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VIII- të rregullt për vitin 2023, të mbajtur më: 27.11.2023, me shumicën e votave miratoi vendimin për plotësimin e Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm me anëtarin e ri, z.Artan Lubovci nga Shtimja.

II

A r s y e t i m: Anëtari i Kuvendit, përkatësisht të Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm z.Adem Ramadani nga Reçaku, me dëshirën e tijë ka dhënë dorëheqje nga posti i anëtarit të Kuvendit të Komunës së Shtimes përkatësisht anëtarit të Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, më datën 09.10.2023, për shkaqe personale.

Me Vendimin e KQZ-së Nr.01/1062/23 të datës 18.10.2023, z.Adem Ramadani është zëvendësuar me anëtarin e ri z.Artan Lubovci nga Shtimja.

Për zëvendësimin e z.Adem Ramadani në Komitetin për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2023 me 11 vota “Për” me 10 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” mori vendim që të zgjedh z.Artan Lubovcin, anëtar i Komitetit për Ambient, Shërbime Publike dhe Urbanizëm.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit
Adnan Ademi